



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES - OBERCIJA ZA ADMIKISTRACIJU

Nr. faks. Br. 106
Data: Datumi: 21.05.2019
ROĐAJNA E FUSHË-KOSOVËS - MUNICIPIALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e gjashtë VI-të, e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 10.04.2019, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Betim Ahmeti, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Arjana Zogiani, Migjen Kolshi, Mehdi Lahu, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Shaban Ademi, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Mungojnë: Aida Alimi, Doruntina Jashari dhe Naser Graicevci.

Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Nurije Fazliu - Drejtore e Administratës, Ramadan Jashanica - Drejtore i Financave dhe Buxhetit, Jakup Ternava - Drejtore i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Nurije Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Jakup Dumani - Drejtore i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Maliq Berisha - Drejtore i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Ekrem Berjani - Drejtore i Zhvillimit Ekonomik dhe Mehmet Gërguri - Drejtore i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Të tjerë: Luigji Brusa, Filip Angra, Dr. Friedrich Hembach, Mr. Andreas Harm, Mr. Mustafë Neziri, përfaqësuesit e Ministrive: Muhamet Malësiu, Florim Canolli, përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it dhe qytetarë të fshatit Harilaç.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstataoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Ndërtimi i objekteve për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të rrezikshme në fshatin Harilaç.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Përshëndes të pranishmit në këtë mbledhje, përfaqësuesit e Komisionit Evropian, Ministrisë së Integrimeve Evropiane, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtarët e Kuvendit të Komunës, nënkyetarin e Komunës, Drejtoret e Drejtive të Komunës dhe gjithë të tjerët, që janë prezent në këtë debat publik në Kuvendin e Komunës tonë, lidhur me mbetjet e mbeturinave të rrezikshme në Kosovë.

Filip Angra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sot jemi prezent këtu që ta sqarojmë ‘Propozimin për ndërtimin e objektit për mbetjet e mbeturinave të rrezikshme’, ku parashihet të jetë një investim prej dympëdhjetë milion eurove. Përmes këtij inestimi synohet të mbledhen mbeturinat e shpërndara në Kosovë, ne do t’i grumbullojmë, ndërsa trajtimi final i tyre do të bëhet dikun tjetër. Ky projekt është identifikuar nga Qeveria e Kosovës dhe bartëse e projektit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ne e kemi financuar një projekt që është kërkesë e qytetarëve të Kosovës, ne jemi këtu që të jepim shpjegimet teknike për funksionimin e projektit

në fjalë. Kjo punë do të jetë e dobishme për Kosovën dhe Komunën e Fushë-Kosovës, sepse parasheh reduktimin e rrezikut nga situata e pranishme tani, ku mbeturinat janë të shpërndara nëpër vende të ndryshme.

Muhamed Malësiu - Përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor: Përshëndes të pranishmit në këtë takim, z Luigji Brusa dhe ekspertët. Për mjedisin është folur shumë në Kosovë pas luftës, por nuk janë ndërmarrë veprimet adekuate. Në vitin 2002-2003 është formuar Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit i cili në fillim ka patur vetëm katër punëtorë, tani i ka tridhjetë punëtorë, mbeturinat e shpërndara janë një industri e rrezikshme, ato janë të shpërndara edhe në tokat bujqësore, pa kritere, ku lokalizohen herbicidet e ndryshme, është bërë një inventarizim jo i plotë i tyre deri tani, ato janë prezente në shtëpitë tona, në banjo, pastaj nëpër kopshtet tona gjenerohen mbetje të rrezikshme, që duhet të trajtohen, sepse e rrezikojnë shëndetin e njerëzve. Propozim për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme, kërkohet edhe me legjisacionin tonë. Fatkeqësisht ne nuk jemi pjesë e Konventës së Bazelit për arsy politike, ne e kemi të pamundur ta zgjidhim vetë këtë problem. Kjo punë ka filluar të debatohet edhe në vitin 2009 nga fondet e Bashkimit Evropian. Vendet për realizimin e këtij projekti në atë kohë janë analizuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës, KFOR-i dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa tani Grupi i Ekspertëve e ka propozuar lokacionin në fjalë të cilin e keni kundërshtuar ju si Asamble Komunale. E rëndësishme është që ky kundërshtim të mos bëhet ‘ad hoc’, i pa momentit, pa analizë të mirëfilltë, sepse ne po kërkojmë që ta mbrojmë shëndetin e njerëzve dhe mjedisin dhe mendojmë se ky projekt është i dobishëm për Kosovën dhe Komunën e Fushë-Kosovës. Ekspertëve pyetjet e para për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin ua kemi bërë ne, me zgjidhjen e problemit të grumbullimit të mbeturinave të rrezikshme, do ta pastronim territorin e Kosovës, mbeturinat do të trajtohen në mënyrë profesionale, e jo si deri tani, do të krijojeshin pika të gjelbërtë në mes të qyteteve tona, transporti dhe ambalazhimi i tyre do të bëhet në mënyrë të sigurtë.

Florim Canolli - Përfaqësues i Ministrisë së Integrimeve Evropiane: Përshëndes të pranishmit në këtë takim, unë jam përgjegjës për kordinimin e donatorëve dhe fondevë të Bashkimit Evropian, ata na kënë dhënë një donacion prej dympëdhjetë milion euro për realizimin e këtij projekti, ky projekt ndërlidhet edhe me një donacion tjetër në shumë prej njëzet e shtatë milion eurove për dekompozimin e Kosovës A, këto mjete financiare do të humbin, nëse nuk lejohet projekti në fjalë. Kosova nuk duhet të humb fondet, mirëpo vendimi mbetet prap në vullnetin tuaj. Këtu e kemi këndvështrimin e banorëve, në po e kryejmë detyrën tonë si nivel qendror dhe nuk jemi që të marrim vendim në shpërputhje me vullnetin tuaj. Në takimin më Kryetarin e Komunës dhe përfaqësuesit e Ministrive kompetente, ne e kemi sqaruar se ky projekt do të realizohet në përputhje me standartet evropiane, nuk është problematikë, në parim ne jemi përcaktuar për këtë lokacion, duhet të ketë një konsultim me juve dhe banorët, andaj propozojmë që ky lokacion të mos hujhet poshtë, por të votohet për realizimin e tij.

Në vazhdim u bë prezantimi i projektit nga përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, tani e ftojmë ta merrë fjalën përfaqësuesin e Kompanisë tonë z. Mustafë Neziri, z. Andreas Harm inxhinier dhe administrim biznesi, z. Friedrich Hembach i përfaqëson institucinet që investojnë dhe unë

inxhinier i mekanikës dhe përpunimit, përgjegjës për Kosovën A dhe projektin për dekompozimin e saj, si dhe planifikimin e deponisë së përkohshme për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme. Në pjesën hyrëse, dua të sqaroi se ky projekt është shumë I nevojshëm, në fillim është caktuar lokacioni, në kuadër të këtyre materieve të rrezikshme hyn edhe detergjentet, ngjyrat e të ngjajshme, në konceptin tonë ne synojmë që të bëjmë magazinimin e përkohshëm të tyre, së pari ato vijnë në magazinë, pastaj dalin prej saj, në transportimin e tyre bëhet një kujdes i caktuar, bëhet inventarizimi, ndarja dhe trajtimi final i tyre. Për arsyen e infrastrukturës fizike është propozuar ky lokacion në rrugën Prishtinë/ Pejë, andaj ne nuk kemi të drejtë ta humbim donacionin prej dympëdhjetë milion eurove të taksapaguesëve evropian. Siguria e projektit është afatgjatë, për komunitetin, sepse e siguron trajtimin e mbeturinave që janë në përdorim dhe hudhen nëpër vendajo adekuate.

Vazhdon me prezantimin e projektit z. Fridrih Hemba: Ju duhet të niseni nga fakti se kjo punë krijon mundësi punësimi për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës, këtu duhet ta kemi parasysh konceptin kryesorë të ekonomisë qarkulluese, aty do të bëhet trasportimi, magazinimi dhe distribuimi i mbeturinave të rrezikshme të riciklueshme, për ruajtjen e përkohshme të tyre. Më pas ai prezantoi modelin e një fabrike të tillë në qytetin e Kellnit në Gjermani, që është vetëm disa qindra metra afér qytetit, shpjegoi përmes shembujve, se si cistern hyn në magazinë, mjetet e transportit për bartje janë të specializuara. Aty qytetarët shëtisin përmes brigjeve të lumi Rajna dhe afér ka qendra të rekreacionit. Shembull tjetër i një fabrike të ngjajshme është ajo në qytetin e Dyseldorfit vetëm gjashtë kilometra larg nga qyteti, ku qytetarët i dorëzojnë mbeturinat e tyre, ato transportohen dhe magazinohen pa asnje problem.

Andreas Harm Përshtendetje, unë prap dua të ndërlidhem me temën dhe përpilimin e dizajnit të magazinës në fjalë, aty do të grumbullohen materiet e rrezikshme, mbeturinat e riciklueshme, do të krijohet siguri për njerëzit dhe mjedisin. Ky projekt hap mundësi për zhvillimin ekonomik, mundëson punësimin e njerëzve dhe siguron të ardhura për familjet e tyre. Operatorët tjerë kyqen në ciklin e zhvillimit të përgjithshëm, ideja është se ky regjion do të ketë përfitime nga ky projekt. Projekti në fjalë do të zbatohet për tre vite dhe do të ketë në fund tridhjetë - katërdhjetë persona të punësuar aty. Aty do të jetë edhe laboratory dhe impianti për trajtimin e ujrave. Qeveria e Kosovës do të mundëson partneritetin publik-privat, përmes sistemit të p.p.p, në kulmin e ndërtesës do të bëjmë prodhimin e energjisë elektrike, të prezantuar në foto, si këto panele solare. Kjo zonë do të shndërrohet në një Qendër për grumbullimin e të ardhurave, për banorët. Kjo pamje është në anën e majtë të malit të Goleshit në afërsi të rrugës magjistrale Prishtinë/Pejë. Do të ketë edhe një ujëmbledhës për ujërat e shiut. Në vazhdim e shpjegoi anën grafike të fabrikës përmes fotove, në hyrje janë kontejnerët, do të jenë dy faza që e garantojnë sigurinë e trajtimit të mbeturinave, ruajtjen e përkohshme të tyre. Kjo fabrikë do të ndërtohet me standartet më të larta të inxhinierisë që janë sot, me sigurimin e objekteve kundër zjarrit, aty do të jenë disa kolektorë, do të bëhet izolimi i ujërave nëntokësore. Aty do të riciklohen mbeturinat e riciklueshme, gjërat e elektrikës, detergjentet, kemikalet, materiet nga kopshtet tona, të gjitha materialet që për momentin janë të dëmshme, do të bëhen të dobishme, do të ndahen. Sistemi i sigurisë së fabrikës do të jetë i

automatizuar, me senzorë, të cilët do të diktojnë çdo problem, nivelin e radioaktivitetit. Ju falënderoi për vëmendjen tuaj.

Luigji Brusa: Në këtë vend do të grumbullohen mbeturinat nga deponitë e egra dhe të ngurta në territorin tuaj, që tani për tani situata është jashtë kontrollit. Mbeturinat e ngurta të ndërtimit janë të hudhura vend e pa vend në gjithë territorin e Kosovës. Tani në këtë fushë mbretëron një sistem i anarkisë, andaj ne po tentojmë që ta krijojmë një Qendër logistike sipas ligjit që është kërkesë edhe e Qeverisë së Kosovës. Ky projekt është i mirë se ardhur në Kosovë dhe në komunën tuaj, vendimi është i juaji.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Ne opinionin tonë lidhur më këtë punë e kemi dhënë më herët.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit, juve znj. Kryesuese, përfaqësuesit e Komisionit Evropian, përfaqësuesit e Ministrive tona dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës. Në prezentimin tuaj ju po paraqitni në diskreditim për neve, këto mbeturina nuk janë në territorin e komunës tonë. Komuan e Fushë-Kosovës është përfituese e projekteve të GIZ-it gjerman për krijimin e mjedisit të pastër. Ne si Ekzekutiv i Komunës, kemi qenë kundër lokacionit në fjalë dhe kemi kërkuar që të gjendet një lokacion më i përshtatshëm. Mjedisi në vendin tonë përmirësohet me vendosjen e filtrave në Kosovën A dhe B, e jo siq po thuani ju se i humbim edhe fondet tjera, ne nuk mund ta bëjmë këtë punë kundër mjedisit në komunën tonë. Kryetari i Komunës nuk është prezent në takim, sepse është akuzuar se po ndikon në Asamblenë Komunale, që nuk është fare e vërtetë, sepse këtë projekt të vlerësuar si të dëmshëm për qytetarët e komunës tonë, e kanë refuzuar në mënyrë unanime të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë këtu dua të flas edhe si banorë i fshatit Harilaç që e kemi kundërshtuar ndërtimin e objektit për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme. Ne mendojmë që kjo mbledhje e jashtëzakonshme është e panevojshme, ne e kemi marrë vendimin tonë unanim për refuzimin e ndërtimit të këtij objekti. Unë kam qenë në takim bashkë me Kryetarin, Nënkryetarin, Ministrat dhe Sekretarin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Arben Çitaku, por edhe në këtë vikend janë bërë matje të tokës në atë zonë të fshatit. Ne banorët e fshatrave Harilaç, Sllatinë e Madhe jemi kundër realizimit të këtij projekti të dëmshëm për qytetarët tonë. Ne nuk jemi kundër donacioneve, por në atë zonë duhet të investohet ne turizëm, sepse është zonë e mbrojtur me standarde kombëtare dhe ndërkombëtare. Shtëpitë e banimit nga lokacioni në fjalë janë larg vetëm 600 metra, andaj ne sugjerojmë që ky projekt të realizohet dikun tjetër ku dëmet janë të vogla. Ajo pjesë është shumë problem, njerëzit aty janë burgos, ne jemi të irrituar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, ne banorët jemi kundër këtij lokacion, por nuk pranojmë që ai të zhvendoset vetëm pak metra larg, sepse efektet e dëmeve janë të njëjta. Ky projekt është tentuar të realizohet edhe në vitin 2009 në Komunën e Drenasit dhe Komunën e Mitrovicës, por nuk është pranuar. Këtu po tentohet të realizohet për arsy politike, por unë ju rikujtoi se mund të ketë edhe viktima apo diçka tjetër, ne këtë punë të dëmshme nuk e lejojmë. Për të mos e zgjatur banorët e fshatit Harilaç kërkojnë që kjo fabrikë të mos bëhet aty.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit, banorët e fshatit Harilaç, përfaqësuesit e Komisionit Evropian dhe përfaqësuesit e Ministrive tona. Ky është një diskutim i jashtëzakonshëm për projektin, unë nuk po e kuptoi, ne si Kuvend i Komunës unanimisht e kemi refuzuar këtë propozim të dëmshëm për qytetarët e komuës tonë. Në atë pjesë janë shtatëmbëdhjetë hektarë zonë e pyllëzuar dhe nuk ka logjikë të shkatërrohen dhe aty të vendoset, fabrika për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme. Arsyet u thanë nga parafolësi im, banorët e fshatit nuk pajtohen, presioni i panevojshëm është bartur pa të drejtë te niveli lokal. Vendi aty është i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit, fakt tjetër është afërsia me Aeroportin Ndërkombëtarë Adem Jashari vetëm 3.5 kilometra, rrezikimi i ujërave dhe kontaminimi i tyre. Kjo mund të bëhet në vendet me drejtësi dhe gjygjësorë të konsoliduar me standarde evropiane, por jo te ne ky sistemi gjygjësorë është i dobët, projektet publiko-private nuk janë të zhvilluara. Ndërtimi i kësaj deponie bjen ndesh edhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2016, lokacioni nen 8, pika 1.1 deri 1.8 thuhet: pika 1,1 ku largësia nga Aeroporti duhet të jetë 4000 metra, pika 1.6 zonë arkeologjike e mbrojtur, pika 1.8 së paku 1000 metra larg zonës së banimit, 500 metra larg lumit, 2000 metra larg ujit të pijes, 50 metra larg hekurudhës, andaj mbështetur në këtë fakte me të cilat bjen ndesh ndërtimi i objektit për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të rrezikshme, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vëtëvendosje është kundër. Përfaqësuesi i Ministrisë është dashur të zgjedh disa vende, por jo këtë lokacion për një projekt të tillë, që është vërtetur se nuk e ka vendin aty, po thuhet se janë dy mbëdhjetë milion euro për riciklimin e materieve të rrezikshme, ne kërkjmë që të ndahet vetem gjysma e tyre, pra gjashtë million euro për zhvillimin e turizmit në këtë zonë. Nuk mundemi ne të krahasohemi më Gjermaninë aspak, atje funksionon ligji, ne ende nuk e kemi sistemin e drejtësisë të konsoliduar dhe efektiv.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, my safirët e nderuar dhe të tjerët, unë do të jem i shkurtër në diskutimin tím, sepse është shterrur debati për këtë temë, ne e kemi marrë një vendim unanim në Kuvendin e Komunës, për refuzimin e ndërtimit të objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme. Sa i përket pjesës teknike furnizimit me material nuk shoh asnjë risi me takimin e kaluar. Lidhur me mbeturinat duhet të zbatohet ligjshmëria. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të ketë një strategji që mbështetet në ligje dhe akte nënligjore, të kemi një prakticitet të zbatimit të ligjshmërisë në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian, ato duhet të zbatohen në mënyrë të rreptë dhe saktësi të plotë. Deponia e këtyre mbeturinave duhet të vendoset në vendet e degraduara, xehroret e braktisura të thëngjillit, vende të tillë në Kosovë ka mjaft. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është organ i thirrur ta ruajë mjedisin, ta zbaton në mënyrë të plotë shkencën mbi mjedisin, pozitën gjeografike, përmbytjet, ujin e pijes, sipërfaqen bujqësore, vendet kulturore, këtu janë afër ‘Kalaja e Harilaçit, ‘Ligatina e Hencit’, afër lokacionit janë lumejt Sitnica, drenica, prishtevka, ka edhe shumë deponi tjera, duhet të ketë kujdes për mbrojtjen e shëndetit të popullit. Ne si Nismë Socialdemokratek kërkjmë nga Qeveria e Kosovës që të shfrytëzon mekanizmat e saj dhe të rivendos për këtë çështje, sepse një deponi e tillë nuk e ka vendin në Komunën e Fushë-Kosovës.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, musafirët e nderuar, ajo që është dashur ta themi ne, e kemi thënë në mbledhjen e jashtëzakonshme të 25 tetorit 2018. Ne i respektojmë

investimet që i ka bërë Bashkimi Evropian në vendin tonë, por një deponi të tillë e kundërshtojmë, sepse jemi përgjegjës për banorët e komunës tonë, këto janë mjete financiare të taksapaguesve evropian, por këtu nuk besoi që mund të zbatohen me përpikëri standardet sikur në Bashkimin Evropian, andaj Qeveria e Kosovës mund të gjen një lokacion tjetër për këtë deponi. Informimi dhe konsultimi për projekte të tillë duhet të bëhet më kohë për qytetarët, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pa asnje konsultim paraprak e ka caktuar Fushë-Kosovën për vendosjen e deponisë për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme, ne e kemi votën e qytetarëve për t'i mbrojtur interesat e tyre. Marrja e një vendimi të tillë e përkeqëson situatën, ne vetëm jemi të atakuar nga ndotësit, Korporata Energetike e Kosovës, por fakti bazë përvëç të tjerëve që kjo deponi nuk e ka vendin në lokacionin e propozuar është afërsia me Aeroportin Ndërkombëtar Adem Jashari dhe këtë e kanë sqaruar shumë mirë ekspertët e Aeroportit në mbledhjen e 25 tetorit 2018. Ne nuk jemi kundër projekteve të tillë, por ka mundësi që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë ta gjen një lokacion tjetër, që nuk ka afërsi me Aeroportin, më vendbanimet, me turizmin. Lidhur me këtë çështje ne e kemi edhe peticionin e banorët të fshatrave: Harilaç dhe Sllatinë e Madhe, për mos ndërtimin e kësaj deponie, jan nuk mund ta akuzoni Kryetarin e Komunës për ndikim në Asamblenë Komunale, as strukturat udhëheqëse të komunës tonë, në jemi përfaqësues të popullit dhe vendimin tonë e kemi marrë në mbledhjen e datës 25 tetor 2018 dhe qëndrojmë prapa, kërkojmë që ky vendim të respektohet dhe deponia e ruajtjes së përkohshme të mbeturinave të rrezikshme në Komunën e Fushë-Kosovës të mos ndërtohet.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kolegët nga bashkimi Evropian e bënë një prezantim të mrekullueshmë por mbrapsht, Kryeministri i Kosovës e ka marrë një vendim ‘ad hoc’, si Bashkim Evropian ju rikujtojmë se kjo punë është gabim, arsyet tjera janë shpjeguar, prej viteve Grupi i Ekspertëve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, KFOR-it, Trupave Mbrotëse të Kosovës, tani Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe nuk kanë gjetur zgjidhje, tani është caktuar ky lokacion i pa pranueshmë, të cilin ne e refuzojmë. Ju përfaqësuesit e Ministrisë së Integrimeve Evropiane, duhet të kordinoni mirë projektet me Bashkimin Evropian që gjenerojnë zhvillim, e jo të na ofroni neve shantazhe këtu se humben donatorët, mjetet e taksapaguesve evropian nëse nuk realizohet ky projekt, që është i dëmshmë për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve, ne vetëm se jemi ta atakuar nga Komuna e Obiliqit, Korporata Energetike e Kosovës si ndotës. Ju po thuani se brenda është laboratori, po e shpejegoni mirë këtë punë, por kjo punë është marrë në mënyrë shumë jo serioze, nga Kryeministri i Kosovës që e ka marrë një vendim ‘ad hoc’, pa konsulime dhe pa na pyetur dhe njoftuar neve fare si institucion lokal dhe sot po tentoni që me forcë ta shtyeni përpara një punë që nuk bëhet. Në mbledhjen e kaluar unë e kam theksuar se ne vetëm e kemi afër një bombë të kurdisur në Mirash, fakte tjera që lokacioni i caktuar është i pa pranueshmë, është Aeroporti, sot nuk po e shoh përfaqësuesin e tyre, por ai në mbledhjen e kaluar i ka shpjeguar arsyet, pse nuk duhet të vendoset kjo deponi në lokacionin e propozuar, aty afër pritet të ndërtohet edhe Stadiumi Kombëtar i Kosovës, qytetarët e komunës tonë janë të millefusur për këto veprime të pa menduara mirë. Kosova ka plotë vende të tjera të harruara për ndërtimin e kësaj deponie, pse është vendosur ky lokacion, e tha edhe Nënkyetari i Komunës, të nderuar ne vendimet tona i marrim vetë, e kemi bindjen tonë për verpimet që i marrim. Kjo deponi e rrezikon

shëndetin e qytetarëve të komunës tonë dhe mjedisin, andaj ne nuk pajtohem me ndërtimin e saj. Ne duhet të punojmë si vend për vetëdijësimin dhe në këtë drejtim është punuar me GIZ-in gjerman në tri katër vitet e fundit shumë, deponitë ilegale duhet t'i eliminojmë, por jo në lokacionin e gabuar, është fakt se është krijuar një kulturë e keqe, por nuk është argument që ajo të bëhet me diçka legale, por prap në mënyrën e gabuar dhe jo në vendin adekuatë. Bashkimi Evropian ka qenë donator edhe për ndërtimin e kësaj komune ku ne jemi tani, për investimin e caktuar ne e falënderojmë, por shiu i parë që ka rënë, kulmi ka pikur dhe uji ka rrjedhur brenda objektit fatëkeqësisht, andaj ne nuk kemi garanci për një projekt të tillë, me rreziqe të mëdha.


Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje dhe mysafirët e nderuar, shumë mendime që unë dëshiroja t'i them, vetëm u thanë nga anëtarë i Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili, ekspertët e shpjeguan, por shumë projekte te ne janë bërë jashtë standardeve dhe kritereve. Kjo magazinë që duhet të ndërtohet, ndot ujërat tokësore dhe nëntokësore për zonën e caktuar, dendësia e popullsisë dhe vendbanimet janë afër, korporata Energetike e Kosovës, rezervuarët e naftës, andaj kjo do të jetë shkatërruese për neve dhe ne nuk mund ta pranojmë, sepse Kosova është një vend pa drejtësi të konsoliduar. Unë pyes, a ka mundësi që kjo deponi të vendoset në vendet tjera si Kroacia, Bosnja, Shqipëria apo Mali i Zi. Transportimi i këtyre mbetjeve kushton dikun 1.5€ deri në 3€ për kilogram, ligji e parashev transportimin e tyre, pse Qeveria e Kosovë nuk ka punuar për rregullimin e kësaj çështje nga viti 2002/2003. Këto mbeturina në vendin tonë ekzistojnë për pesëmbëdhjetë vite, nëse ndërtohet ky objekt e pengon Aeroportin, intervenimin, klasifikimin dhe ndarjen e tyre, por ju e dini rastin e Gérdecit në Shqipëri që është dëgjuar edhe te ne 300 kilometra larg kur ka shpërthyer, këto punë dojnë profesionalizëm, vendi ynë nuk mund ta bënë këtë. Thuhet se do të bëhet sipas standardeve të Bashkimit Evropian, por ne nuk jemi të bindur për këtë, duke I marrë parasysh, shumë gjëra si realizohen në vendin tonë, andaj jemi kundër.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Pas diskutimeve e konstatoi qëndrimin e subjekteve politike të përfaqësuarë në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës, se mbeten në qëndrimin e dhënë me vendimin për refuzimin e ndërtimit të objektit për trajtimin e përkohshëm të mbeturinave të irrezikshme në Kosovë, të marrë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës të mbajtur me datën 25.10.2018.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.
Mbledhja përfundoi në oren 12:05 minuta.**

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevcı



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

